

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE**  
**“ THE HR CONSULTANCY SERVICES ” SHPK**

Themelimi

Neni 1

Shoqeria “ THE HR CONSULTANCY SERVICES ” themelohet nga ortaku i vetem SANDEEP BOHORA I biri i Prem Bohora dhe Sita Devi Bohora, shtetas Indian lindur me 31.05.1981 ne Delhi, Indi mbajtes i pasaportes me nr Z6720801

**EMERTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

NENI 2

Emertimi

Emertimi i shoqerise eshte “ THE HR CONSULTANCY SERVICES ”

Neni 3

Forma Ligjore

3.1 Shoqeria eshte e formes me perjegjesi te kufizuar dhe eshte themeluar ne perputhje me legjislacionin tregtar ne Shqiperi .

3.2 Shoqeria mund te shnderrohet ne ndonje forme tjeter ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 4

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne perputhje me kete Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita te tjera ligjore.

NENI 5

Kohezgjatja e veprimtarise

Shoqeria e fillon veprimtarine e saj me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Biznesit (“QKB”)

Afat i veprimtarise se shoqerise eshte per nje afat te papercaktuar.

Neni 6

*Jendee~~z~~*

## Selia

6.1 Selia e shoqerise eshte ne adresen : ZONA KADASTRALE 2066, VOLUMI 17, FQ .229, NR PASURIE 208/14/ND3, KAMEZ, TIRANE

6.2 Adrese komunikimi elektronik i shoqerise: hrconsultancyservices22@gmail.com;

6.3. Administratori mund te vendose te hape dege dhe/ ose filiale, dhe/ose adrese sekondare, dhe/ose zyra perfaqesimi te shoqerise brenda territorit te Shqiperise ashtu dhe jashte saj, ose mund te cregistroje ato egzistuese sipas ligjeve ne kufi.

6.4 Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera shqiptare qe eksiztojne ose do te krijohen ne te ardhmen ne Shqiperi dhe/ose jashte saj me vendim te administratorit te shoqerise.

## Neni 7

### Emblema. Vula

Shoqeria do te kete emblemen e saj dhe vulen.Vula do te perdoret nga administratoret e shoqerise

Forma dhe permasat e vules do te percaktohen ne perputhje me rregullat e legjisacionit shqiptar.

Te gjitha dokumentet e shoqerise duhet te permabajne emblemen dhe vulen e saj.

## Neni 8

### Objekti

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: Sherbime te ndryshme ne fushen e turizmit dhe sherbime keshillimi ne fushen e burimeve njerezore;

Objekti mund te ndryshohet me vendim te Ortakut te Vetem

## Neni 9

### Kapitali


Kapitali themeltar i shoqerise eshte:100.000 (njeqind mijë) leke

Ortaku i vetem zoteron 1( nje) kuote

Kapitali eshte shlyer teresisht.

## Neni 10

Transferimi i kuotave. Kufizimet



10.1 Kuotat mund te transferohen te te tretet ne perputhje me dispozitat e Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" me amendimet perkatese.

10.2 Vendosja e cfaredolloj barre mbi kuotat ne favor te paleve te treta do te lejohet vetem me pelqim te Ortakut te Vetem.

Neni 11

#### Rritja e Kapitalit

11.1 Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Ortakut te Vetem.

11.2 Zmadhimi i kapitalit mund te behet gjithashtu edhe nepermjet nenshkrimit dhe shlyerjes se pjeseve te tjera te kapitalit nga ortake te rinj. Ortaket e rinj pranohen dhe miratohen si te tille me vendim te otakut te vetem.

Neni 12

#### Zvogelimi i kapitalit

12.1 Zvogelimi i kapitalit behet sipas procedurave te parashikuara nga legjislacioni tregtar.

12.2 Propozimi i zvogelimit do t'i paraqitet ekspertit kontabel te autorizuar dhe administratorit te pakten 45 dite perpara marrjes se vendimit nga Ortakut i Vetem i shoqerise. Eksperti kontabel dhe administrator do te shqyrtojne propozimin dhe do t'i paraqesin ortakut te vetem raportin ne lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogelimit te kapitalit

12.3 Raporti I zvogelimit te kapitalit do te miratohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

### ORGANET E SHOQERISE

Neni 13

#### Vendimet e ortakut te vetem


13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarine e shoqerise merren nga Ortaku i Vetem i saj.

13.2 Vendimet e Ortakut te Vetem perfshijne kryesisht:

-Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;

-Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise;

-Prishjen dhe likujdimin e shoqerise;



- Emerimin ose shkarkimin e administratorit ose administratoreve te shoqerise dhe percaktimin e shperblimit per ta;
- Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel dhe percaktimin e shperblimit per ta;
- Miratimin e bilancit te shoqerise e pasqyrave finanicare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Transformimin e shoqerise ne forma te tjera.

Neni 14

#### Administrimi


14.1 Administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator ose nje grup administratoresh qe caktohen me vendim te Ortakut te Vetem.

14.2 Administratori ka te drejte te perfaqesoje shoqerine dhe drejtoje punen e perditshme te shoqerise ne perputhje me udhezimet e Ortakut te Vetem.

14.3. Administratori i shoqerise eshte z. SANDEEP BOHORA I biri i Prem Bohora dhe Sita Devi Bohora, shtetas Indian lindur me 31.05.1981 ne Delhi, Indi mbajtes i pasaportes me nr Z6720801

14.4 Administratori eshte perjegjes per veprimtarite e meposhtme:

- Drejtimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise
- Perfaqesimin e shoqerise ne marredhenie me te tretet personalisht ose me perfaqesim;
- Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimin per ndarjen e fitimeve;
- Pergatitjen e dokumentave ne emer te shoqerise sipas kompetencave qe zoteron;
- Te zhvilloje veprimtari te tjera te cdo lloj natyre per te miren e shoqerise dhe realizimin e objektit te saj;
- Te perfaqesoje shoqerine ne Shqiperi tek palet e treat, institucionet apo entitete publike ose private;
- Te lidhe per dhe ne emer te shoqerise , kontrata me pale te treta;



-Te punesoje dhe pushoje punemarres apo staf tjeter qe konsiderohet i nevojshem per mbarevajtjen e biznesit ne Shqiperi;

-Te vendose per ndryshimin e selise se shoqerise;

-Te perfaqesoje shoqerine ne Shqiperi perpara bankave te nivelist te dyte dhe Bankes se Shqiperise si dhe te kryeje ne emer te shoqerise cdo transaksion bankar;

-Te ndermarre cdo veprimtari tjeter ose biznes ose aktivitet I cili konsiderohet I nevojshem per biznesin e shoqeris ne Shqiperi;

14.5 Mandati i administratorit do te jete i vlefshem per 5 (pese ) vjet me te drejte riperteritje ose deri ne castin e revokimit te tij me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 15

Viti finanziar

Viti finanziar I shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 janari deri me 31 dhjetor te cdo viti.

Si perjashtim, viti i pare finanziar i shoqerise do te filloje nga dita e regjistrimit te shoqerise ne zyren e tatim taksave dhe perfundon me 31 dhjetor te po atij viti.

Neni 16

Bilanci.Kontabiliteti

16.1 Bilanci vjetor i shoqerise shqyrtohet nga Ortaku i Vetem dhe duhet te pergatitet per t'u paraqitur para organeve tatimore deri ne fund te muajit mars te vitit pasardhes.


16.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe monedhen shqiptare dhe sipas kerkesave te legjislacionit perkates.Per operacione te vecanta, shoqeria mund te beje veprime edhe me llogari te vecanta ne monedhe te huaj duke bere konvertimin brenda vittit.

16.3 Shoqeria mund te pranoje fonde nga institucionet financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte. Per kete qellim, shoqeria mund te lere peng pjese te kapitalit si garanci ose mund te hipotekoje pasurite e saj te paluajtshme, vetem me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 17

Te ardhurat..Dividenti

17.1 Shoqeria do te krijoje fonde rezerve per realizimin e qellimit te biznesit te saj ne perputhje me kerkesat e Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"



17.2 Te ardhurat qe rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, pas pagimit te tatimeve, mund t'i kalojne Ortakut te Vetem.

17.3 Humbjet e shoqerise do te mbulohen deri ne kufirin e kapitalit themeltar dhe ortakuu do te per gjigjet deri ne kufirin e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit te pare, deri ne tre ushtrimoret vijues.

Neni 18

Likujdimi

18.1 Prishja e shoqerise vendoset me vendim te Ortakut te Vetem .

18.2 Me vendimin e Ortakut te Vetem caktohet nje likuidator ose nje grup likuidatoresh qe do te plotesojne procedurat e likuidimit.

18.3 Likuidatori do te per gatise raportimin e likuidimit mbi gjendjen ekonomike te shoqerise, rreth operacioneve te metejshme te likuidimit de kohen qe nevojitet per perfundimin e tij. Ne perfundim te kesaj procedure, Ortaku I Vetem do te shqyrtoje bilancin perfundimtar dhe do te miratoje perfundimin e procedurave te likuidimit

Neni 19

Mosmarreveshjet

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteve, ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim, do t'i nenshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Neni 20

Klauzole mbyllese


Ky Statut hartohet ne 4 (kater) kopje me fuqi te njejte ligjore

Tirane, date 29.10.2022

“THE HR CONSULTANCY SERVICES ”

Ortaku i Vetem

SANDEEP BOHORA

  
Sandeep Bohora